



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

“MIREMBAJTJA E RRUGËS KARDHIQ-DELVINË, LOT-7 (TUNELI)”

TIRANË 2023



TIRANË 2023

A. PËRMBLEDHJE HISTORIKE MBI PROJEKTIN

Objektivi kryesor i Qeverisë Shqiptare në Sektorin e Transportit është edhe ndërtimi i segmentit rrugor Kardhiq–Delvinë (33km) i cili lidh qytetin e Gjirokastrës dhe Sarandës. Ky është një projekt transformues për zhvillimin e infrastrukturës me impakt në ekonominë dhe turizmin e vendit për në bregdetin e Jugut. Kjo rrugë është cilësuar një nga akset më prioritare, që shkurton në 3 orë kohën e udhëtimit nga Tirana deri në Sarandë, duke i dhënë një hov të mëtejshëm turizmit.

Ky projekt do të ndihmojë në lehtësimin e trafikut ndërmjet kryeqytetit të Shqipërisë dhe qytetit të Sarandës, që konsiston në reduktimin e kohës së udhëtimit, reduktimin e numrit të aksidenteve dhe përmirësimin e sigurisë rrugore, duke evituar kështu kalimin nga Qafa e Skërficës, e cila evidentohet si një rrugë mjaft e vështirë në një terren malor.

Loti.7 në të cilin ndodhet Tuneli Skërficës përfaqëson aksin rrugor i cili ndodhet në një distancë 8 km në perëndim të qytetit të Gjirokastrës. Loti.7 ndodhet nga km 6+150- km 8+760. Gjatësia Totale e Lotit.7 është 2,610m (në të cilën përfshihet 1.314m rrugë e asfaltuar). Terreni që përshkon ky lot është kodrinor dhe malor dhe në përgjithësi seksioni tërthor i rrugës është në gjermim dhe një pjesë e tij në dalje të tunelit është në mbushje.

Ky është segmenti me kushte më të vështira si nga ana ndërtimore dhe gjeologjike. Qafa e Skërficës është e rrethuar me male të larta që janë të zhveshura nga bimësia.

Karakteristikat Gjeometrike të Lotit.7.

Ky Lot parashikon ndertimin e :

- **Tunelit të Skërficës** me gjatësi 1.347,5m, me një tub (galeri) dhe ka dy korsi lëvizjeje (vajtje –ardhje).
- **Tunelit SOS** me gjatësi L=732m (km 6+150-km 7+650).
- **Rruget hyrëse dhe dalëse** nga tuneli të kategorisë C2.

Sasia e trafikut që lëviz përgjatë tunelit është rritur dhe shumëfishohet në periudha të veçanta të rasteve të festave apo dhe pushimeve verore e dimërore.

Ky segment rrugor aktualisht ka përfunduar fazën e ndërtimit në fund të Dhjetorit/2022 dhe aktualisht është në periudhën e Garancisë së Difekteve e cila zgjat 2 (dy) vjet.

B. OBJEKTIVAT E KONTRAKTORIT TË OPERIMIT TË TUNELIT

Bazuar në Ligjin 158/2013 “Për sigurinë në tunelet rrugore”, “**Menaxheri i Tunelit**” është organi, publik ose privat, përgjegjës për menaxhimin e një tuneli rrugor në fazën përkatëse, në pajtim dhe sipas dispozitave të këtij ligji.

Aktualisht, Tuneli i Skërficës është në fazën e shfrytëzimit të tij.

1. Si objektive themelore e Kontraktorit të Menaxhimit të Tunelit, këtej e tutje i quajtur “Menaxheri i Tunelit”, do jetë që të sigurojë mbi të gjitha sigurinë, efektivitetin dhe efikasitetin në punë si dhe operimin sa më ekonomik të tunelit dhe aksesëve të tij në përputhje me qëllimet e Direktivës së BE 2004/54/EU mbi kërkesat minimale të sigurisë për tunelet e Rrjetit Rrugor Trans-Europian si dhe Ligjit Nr 158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore” në Republikën e Shqipërisë.
2. Të sigurojë mirëmbajtje efektive, cilësore dhe ekonomike për makineritë operuese dhe të gjitha punimet e montimit që janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në tunel.
3. Kontraktori duhet të garantojë:
 - i. Kostot për gjeneratorin me qëllim furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike
 - ii. Furnizimin dhe vendosjen e çdo makinerie zëvendësuese që mund të nevojitet për ecurinë e shërbimeve në tunel (subjekt i miratimit të Punëdhënësit).
 - iii. Furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve, impianteve, sistemeve dhe pjesëve konsumuese dhe mirëmbajtja e tyre (subjekt i miratimit primar të Punëdhënësit).
 - iv. Ruajtjen e sigurtë, rinovimin dhe magazinimin e kabinave të kontenierëve që janë pozicionuar në hyrje të tunelit (drejtimi Gjirokaster-Sarandë).

- v. Kontrollin, mirëmbajtjen dhe pajisjen me sinjalistikën e duhur të tunelit .
- vi. Kontrollin, mirëmbajtjen dhe shërbimet për linjën 110/35/6 KV, Fiderin e Kardhiqit, që furnizojnë tunelin nga Nënstacioni Gjirokaster e Vjetër .
- vii. Ruajtjen e sigurtë të nënstacionit të tunelit me të gjithë aparaturat dhe pajisjet që përmban (transformatorët, gjeneratorët, ups, e tjerë).

4. Në përmbajtje të objektivave të përshkruara më lart, Kontraktori, në cilësinë e Menaxherit të Tunelit do të paraqesë një program pune dhe procedura të cilat do të sigurojnë që:

- Menaxheri i Tunelit do të marrë direktiva nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së, i cili deri në një njoftim tjetër, do të njihet si Autoriteti Administrativ (Punëdhënësi), dhe Menaxheri i Tunelit do të ketë autoritet dhe do të përmbushë gjithë përgjegjësitë në përputhje me Direktivën e BE 2004/54/EU mbi kërkesat minimale të sigurisë për tunelet në Rrjetin Rrugor Trans-Europian dhe Ligjit Nr 158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore” në Republikën e Shqipërisë.
- Menaxheri i Tunelit do të administrojë tunelin në përputhje me Direktivën e propozuar të Bashkimit Europian dhe çdo përjashtim operativ i pashmangshëm nuk do të zbatohet ose bëhet efektive, pa miratimin me shkrim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), si autoriteti përgjegjës për zbatimin e të gjithë aspekteve të sigurisë në tunelet rrugore.
- Menaxheri i Tunelit do të propozojë, kryejë dhe regjistrojë një program të rregullt mbi punimet e mirëmbajtjes dhe punimet për zëvendësimin e pjesëve të konsumueshme së bashku me provat dhe testimet e pajisjeve, sistemit SCADA si dhe pajisjeve të tjera operuese/monitoruese në Qendrën e Kontrollit me qëllim garantimin e funksionimit të përhershëm.
- Menaxheri i Tunelit do të koordinojë aktivitetet e tij me ato të shërbimit zjarrfikës lokal si dhe duke mbajtur kontakte me shërbimet e policisë së zonës, në mënyrë që dhe këto dy shërbime të tjera të veprojnë së bashku me Menaxherin e Tunelit si një njësi e bashkuar e cila do të jetë efektive në ndalimin e çdo mjeti mbi normat e lejuara, ose të pasigurtë në tunel, kontrollin e sigurtë të fluksit të trafikut dhe të përgatitur ndaj çdo situatë emergjente.
- Menaxheri i Tunelit duhet të justifikojë konsumin e karburantit për vënien në punë të gjeneratorëve rezervë në kohën kur energjia kryesore mungon, ose kur ka luhajtje jashtë kufijve të funksionimit normal të aparaturave dhe pajisjeve, si dhe mbajtjen e tyre gjatë gjithë kohës në gjendje gadishmërie .

Menaxheri i Tunelit do të rishikojë/vendosi në shërbim dhe në fund të dorëzojë të gjithë manualët e operimit, raportet, protokollat e mirëmbajtjes, inventarët e magazinave, menaxhimin e rrezeve dhe sistemet e emergjencës që kërkohen për vazhdimësinë e operimit të tunelit.

C. QËLLIMI I PUNIMEVE

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), nëpërmjet procedurës së prokurimit sipas LPP-së, ka për qëllim të nënshkruaj kontratë, sipas së cilës kontraktori (në cilësinë e Menaxherit të Tunelit) do të

jetë përgjegjës për menaxhimin dhe mirëfunksionimin e tunelit, ambientet përreth tij, si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve të operimit të tunelit.

Menaxheri i Tunelit, sikurse shpjegohet edhe më lart, do të sigurojë shërbimet e kërkuara të menaxhimit/operimit të tunelit dhe shërbimet e kërkuara të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pajisjeve të tij në bashkëpunim me ARRSH-në, Strukturat e Policisë, Brigadën e Shërbimit të Zjarrfiksave të Tunelit, si dhe gjithë autoritetet e tjera të përfshira për këtë qëllim.

Menaxheri i Tunelit do të sigurojë gjithë shërbimet e kërkuara për operimin dhe menaxhimin e tunelit si dhe mirëmbajtjen e funksionalitetin e pajisjeve të tij gjatë periudhës së kontratës, madje dhe ndonjë tejkëqitje kontraktuale të kësaj periudhe në rast se do të mund të jetë e nevojshme (sipas percaktimeve të LPP-së).

Menaxheri i Tunelit duhet ti përgjigjet çdo kërkesë të gjithë institucioneve dhe autoriteteve të interesuara me objektin. Këto institucione do të jenë, por pa limituar, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe furnizuesit e tjerë të shërbimeve, autoritetet rajonale, spitalet rajonale dhe shërbimi i ambulancës, degët e ndryshme të forcave të policisë, Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes në ARRSH si edhe drejtoritë administrative rajonale dhe kombëtare.

Në mënyrë të veçantë, Menaxheri i Tunelit duhet të jetë gjithmonë në kontakt të drejtpërdrejtë me shërbimet e emergjencës si dhe ARRSH-në. Menaxherit të Tunelit do t'i jepen detajet e kontakteve në mënyrë që ky i fundit të ndërmarrë urgjentisht veprimet e duhura dhe të njoftojë menjëherë personat e kontaktit lidhur me emergjencat e ndodhura.

Përbërja e njësisë së operimit (ndërrhyrjes) së tunelit për periudhën e kërkuar në procedurën e prokurimit do të propozohen nga Menaxheri i Tunelit.

Stafi kryesor do të përfshijë:

Bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr 648 datë 22.07.2015 “ Për Miratimin e kriterëve të caktimit të Menaxherit , Oficerit të sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore” është e domosdoshme që:

- a. **Drejtuesi Teknik**, përgjegjës për menaxhimin e tunelit duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri ndertimi ose inxhinieri mekanike (dega transport) dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në administrimin e trafikut.

Staf kyç në menaxhimin e tunelit , do të jenë:

1. **Menaxher Primar i Operimeve në Tunel / Oficer për Sigurinë (n j ë)** duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri ndertimi ose inxhinieri mekanike (dega transport) si dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore.

Oficeri i Sigurisë kryen detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

- a) Siguron kordinimin dhe shërbimet e emergjencave dhe merr pjesë në përgatitjen e skemave operacionale.

- b) Merr pjesë në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin e operacioneve të emergjencës.
- c) Merr pjesë në përcaktimin e skemave të sigurisë, specifikimin e strukturës, pajisjeve dhe veprimit në tunel.
- d) Verifikon që stafi operacional dhe shërbimet e emergjencave janë trajnuar dhe ai duhet të marrë pjesë në organizimin e stërvitjeve që do të mbahen në intervale të rregullta.
- e) Jep këshilla në administrimin për strukturat, pajisjet dhe shfrytëzimin e tuneleve.
- f) Verifikon që struktura e tunelit rrugor dhe pajisjet janë mirëmbajtur dhe riparuar
- g) Merr pjesë në vlerësimin e incidentëve dhe aksidenteve sipas Nenit 6 (pika 3 dhe 4) të ligjit Nr 158/2013 “ Për Sigurinë në Tunelet Rrugore”.

Prezenca në kantier e Menaxherit Primar të Operimeve në Tunel/ Oficer për Sigurinë, kërkohet për një periudhe kohore 48 muaj.

2. **Përgjegjës i Mirëmbajtjes së Pajisjeve (një), me edukim arsimor inxhinieri mekanike, elektrike ose elektronike** (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjes për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.

Prezenca e Përgjegjësit të Mirëmbajtjes së Pajisjeve kërkohet për një periudhë kohore 48 muaj.

3. **Operatorë Lokalë Tuneli (tre).** Menaxheri i Tunelit duhet të punësojë staf të trajnuar. Kërkohet që stafi i trajnuar të ketë staf mbështetës për sistemin e punës me turne, por këta të fundit gjithmonë do drejtohen nga Menaxheri Primar Tunelit në detyrë dhe në kontroll të turnit operues të radhës.

Prezenca e Operatoreve Lokale kërkohet për një periudhë kohore 48 muaj.

Gjithashtu, Menaxheri i Tunelit duhet të ketë Staf Jo-Kryesor (mbështetës) minimalisht si më poshtë:

4. **Teknik Mirëmbajtje Pajisjesh 1(një),** të kualifikuar mjaftueshëm dhe me eksperiencë, që do trajnohen dhe drejtohen nga Përgjegjësi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, gjatë rrjedhës së kontratës, sipas Planit të Sigurimit të Cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve që do operojnë në tunel.

Prezenca e Teknikut të Mirëmbajtjes së Pajisjeve kërkohet për një periudhe kohore 48 muaj

5. **Menaxher Personeli / Financier (një)** i cili do të menaxhojë burimet njerëzore të Menaxherit të Tunelit si edhe financën e kësaj Kontratë;

Prezenca e Menaxherit të Personelit / Financier, kërkohet për një periudhe kohore 48 muaj.

6. **Elektracist i specializuar (një)** i cilet do të mbulojnë situatat e pajisjeve elektrike të

tunelit **për një periudhe kohore 26,7 muaj.**

7. **Mekanikë i specializuar (një)** i cili do të mbuloj situatat e pajisjeve mekanike të tunelit **për një periudhe kohore 26,7 muaj**
8. **Hidraulikë i specializuar (një)** i cili do të mbuloj situatat në hidrantët dhe pajisjet e tjera hidraulike të tunelit **për një periudhe kohore 26,7 muaj.**
9. **Shoferë (nje)** për auto-vinc me kovë dhe karrotrec **per nje periudhe kohore 48 muaj**
10. **Shoferë (nje)** për fuoristrade (4 x 4) **për një periudhë kohore 48 muaj.**

Zerat nga Nr.Rendor (6-8) kerkohen te jene prezent ne objekt per 26,7 muaj gjithsej (1 here ne jave ose 4 here ne muaj) duke marre ne konsiderate faktin se kontraktori aktual eshte ne periudhen e garancise se difekteve deri ne fund te 2024 (24 muaj) .

Stafi mbështetës duhet të përfshihet në Ekipet e Mirëmbajtjes dhe Operimin të Tunelit. Kualifikimi dhe eksperiencia e stafit mbështetës duhet të prezantohet në Propozimin Teknik të Menaxherit të Tunelit, pavarësisht se stafi mund të mos limitohet në sasi të përkrahura më sipër por edhe të zgjerohet më tej numrit të përcaktuar në kritere. Megjithatë, insuficensa e kualifikimit të nevojshëm të stafit mbështetës do të çojë edhe në refuzim të Propozimit Teknik. Menaxheri i Tunelit do përfshijë në Propozimin Financiar gjithë stafin e plotë të tij (si stafin kryesor dhe atë mbështetës).

Menaxheri i Tunelit duhet të paraqesë detajet e stafit të tij për këtë Kontratë, sikurse është përcaktuar në Dokumentat e Tenderit.

11. Kosto per Operime Shtesë dhe Mirëmbajtjen e Makinave

Këtu përfshihen kryesisht por pa u kufizuar shërbimet lidhur me shpenzime për karburantin, për mirëmbajtjen e makinerive si servis/shërbime për mirëmbajtjen dhe defektet që mund të ndodhin duke marre parasysh që automjetet janë në proces pune në vijimësi.

12. Totali i lejuar për mirëmbajtje tuneli (Lum Sum)

Kjo shume perfshin; a) mirëmbajtje totale të “Zones Tunelore” bazuar në (Ligji No.158/2013,Neni 3,pika 6,) ku përfshihen edhe punimet e ndertimit dhe mirembajtjes bazuar ne (Shtojcen I, Neni 3, pika 3,3), b) ambjentet përreth tij si dhe shërbimet & pastrimi i qendres së kontrollit, c)largimi i mjeteve në avari dhe aksidente, d) transporti i stafit të operatorit të tunelit, e) pastrim/larje muresh të tunelit, f) sinjalistike horizontale mbas perfundimit të periudhës së Garancisë së Difekteve nga Kontraktori aktual.

Kontigjenca për parashikimet sipas Seksionit B3 të Termave të Referencës , si më poshtë:

13. Konsum karburanti për gjeneratorët sipas pikës (I),

Seksioni B3 të Termave të Referencës është parashikuar një shumë e caktuar për 48 muaj. Nga eksperiencat e deritanishme, mbi ndërprerjet apo luhatjet e energjisë, referuar kontratave të lidhura në institucion në vitet (2016-2021) me natyrë të njëjtë shërbimi, si edhe situates se deritanishme te venies ne eficence te Tunelit te Skerfices, rezulton që për kompensimin e karburantit të gjeneratorëve është e domosdoshme një shumë e caktuar, e cila do te paguhet vetem pasi të justifikohet nga evidencat e nderprerjeve reale te marra nga OSHEE, Gjirokaster.

Ky dokumentacion konsiston në paraqitjen e ndërprerjeve dhe luhatjeve të të dhënave të këtij sistemi.

14. Kontigjencë për parashikimet sipas pikave (ii,iii,iv,v,vi,vii) Seksionit B/3 të Termave të Referencës.

Është menduar fond kontigjence për periudhën 48-mujore, me qëllim zëvendësimin e pajisjeve, aparaturave e makinerive që pësojnë defekt, atyre që i kanë kaluar orët e punës. Kjo vlerë bazohet në eksperiencën e deritanishme aplikuar në kontrata të realizuara me të njëjtën natyrë shërbimi.

Theksojmë se, ky zë është miratim primar i Punëdhënësit dhe realizohet vetëm nëpërmjet materialeve mbështetëse me proces verbale, fletë nga ditari i turneve, foto, video etj.

Zerat (ii-vii) te Seksionit B3 te Termave te References do te paguhen/financohen nga Punedhenesi a) vetem mbas paraqitjes së Fletë Garancisë (në të cilën parashikohet periudha dhe specifikimet përkatëse) të pajisjeve /aparaturave të ndryshme të cilat do të duhet të zëvendësohen në rast mosfunsonimi dhe b) mbas përfundimit të periudhës së Garancisë së Difekteve nga Kontraktori aktual i cili e ka obligim kontraktual (2vjet).

C1. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E MENAXHERIT TË TUNELIT

1. Tunelet jane projektuar që të permbushin kerkesat e Direktivave BE 2004/54/EC si dhe Ligjin 158/2013 “ për Sigurinë në Tunelet Rrugore”. Kjo Direktivë e BE-së dhe ky Ligj (i cili është bazuar ne Direktivën e BE-së) jo vetëm përcaktojnë aspektet e projektimit të tunelit, por ato japin gjithashtu edhe gjithë specifikimet e nevojshme në lidhje me:

- Çështjet administrative e procedurale gjatë periudhës së projektimit, ndërtimit dhe fazës operacionale të tunelit;
- Çështjet proceduriale për procesin e komisionimit.
- Çështjet gjatë shfrytëzimit të tuneleve

Menaxheri i Tunelit do të rishikojë situatën në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen e deritanishme të tunelit si dhe:

- Të raportojë në ARRSH (Punëdhënësi), për çdo mospërputhje me Direktivën;
- Të propozojë masa të vlefshme që duhet të ndërmerren për të korrigjuar këto mospërputhje, dhe;
- Të analizojë risqet e mundëshme dhe të bashkëpunojë me Punëdhënësin për shmangien e ndonjë mosfunksionimi operacional përpara se ai të ndodhë.

2. Menaxheri i Tunelit do të caktojë një Menaxher Primar të Operimeve në Tunel, dhe pritet që përveç detyrave të tij manaxheriale dhe administrative, ky i fundit të kryejë edhe detyrimet e Menaxherit të Tunelit dhe Oficerit të Sigurisë në përputhje me Direktivën. Prezenca e përhershme e Menaxherit Primar të Operimeve të Tunelit dhe Oficerit të Sigurisë është e domosdoshme në tunel dhe në rast se në grafikun e prezencës së Menaxherit të Tunelit, është parashikuar të largohet apo mungojë, Menaxheri i Tunelit duhet t'a zëvendësojë menjëherë me një person që të plotësojë kriteret e përcaktuara për këtë pozicion (subjekt i njoftimit primar të Punëdhënësi dhe miratimit të këtij të fundit).
3. Menaxheri i Tunelit do të mirëmbajë të gjithë pajisjet dhe sistemet operuese të tunelit në përputhje me Planin e miratuar për Sigurimin e Cilësisë.
4. Menaxheri i Tunelit (në përputhje me specifikimet e Artikullit 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE), do të përgatisë, organizojë dhe stimulojë periodikisht situata emergjence me qëllim angazhimin dhe trajnimin e shërbimeve të emergjencës në situata reale që mund të ndodhin në tunel, si dhe dhëjen e efekteve reale. Këto ushtrime do të ndërmerren në koherencë me të gjitha autoritetet e tjera të përfshirë në këtë proces.
5. Menaxheri i Tunelit (në përputhje me Artikullin 13 të Direktives së BE-së), do të përgatisë gjithë analizat për rreziqet që mund të dalin gjatë fazave të ndryshme të funksionimit dhe operimit të tunelit, duke plotësuar kështu një Rregjistër Risku.
6. Menaxheri i Tunelit do të asistojë dhe të ndërmarrë inspektime mbi sigurimin e standartit të funksionimit të tunelit, të mirëmbajtjes së makinerive, (si edhe instalimet fizike dhe kontrollin e veprimtarive të përditshme), nëpërmjet inspektorëve përcaktuar nga Menaxheri i Tunelit.
7. Menaxheri i Tunelit do të përgatisë dhe lëshojë Dokumentin e Miratuar të Sigurisë për funksionimin e tunelit, e cila përveç dokumentacionit të kërkuar në fazën e projektimit do të përfshijë:
 - Përshkrimin e organizimit, burimet materiale dhe njerëzore si dhe udhëzimet e specifikuar nga Menaxheri i Tunelit për të garantuar sigurinë, operacionet efektive dhe ekonomike në mirëmbajtjen e tunelit;
 - Një plan për përballimin e emergjencave të përgatitur së bashku me shërbimet e emergjencës
 - Përshkrimin e sistemit të një feedback-u të përhershëm të eksperiencave, nëpërmjet të cilit të mund të regjistrohen dhe analizohen incidente dhe aksidente të përmasave të mëdha.
8. Menaxheri i Tunelit do të përgatisë dhe lëshojë Dokumentacionin e miratuar të Sigurisë për funksionim të tunelit e cila përveç dokumentacionit të kërkuar në fazën e komisionimit, do të përfshijë:
 - Një raport dhe analizë të incidenteve dhe aksidenteve të rënda që kanë ndodhur në tunele nga hyrja në fuqi e Direktivës së BE-së;
 - Një analizë të gjithë asaj që përvetësohet nga këto incidente e aksidente dhe masat që do merren parasysh për çdo rast të ngjashëm në tunelin e Krrabës.
9. Kryerja e ushtrimeve periodike:

Bazuar në shtojcën 2, pika 5 të Ligjit 158/2013 “ Për sigurinë në tunelet rrugorë”:

Menaxheri i tunelit dhe shërbimet e ndërhyrjes organizojnë, në bashkëpunim me oficerin e sigurisë, ushtrime stërvitjeje periodike të përbashkëta për personelin e tunelit dhe shërbimeve të ndërhyrjes. Këto ushtrime stërvitjeje:

- duhet të jenë sa më realiste që mundet dhe t’u përgjigjen skenarëve të ndodhive të përcaktuara;
- duhet të japin rezultate të qarta të vlerësimit;
- duhet të shmangen shkaktimet e dëmeve në tunel; dhe
- mund të realizohen, gjithashtu, pjesërisht nën formën e ushtrimit stërvitjes mbi tavolinë ose e ushtrimeve stërvitjeje të simulimit mbi kompjuter për të marrë rezultatë plotësuese.

a) Ushtrime stërvitjeje të kryera të natyrës direkte, në kushte sa më realiste që mundet, realizohen të paktën çdo katër vjet. Mbyllja e tunelit do të kërkohet vetëm nëse masa të pranueshme mund të merren për të shmangur, devijuar, ndërruar drejtimin e lëvizjes,

qarkullimit, ushtrimet, stërvitjet e pjeshme dhe/ose me simulim kryhen çdo vit në intervale.

b) Oficeri i sigurisë dhe shërbimet e ndërhyrjes vlerësojnë bashkërisht këto ushtrime stërvitjeje, hartojnë një raport dhe bëjnë propozimet e duhura.

C2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E STAFIT TË KONTRAKTORIT

1. **Menaxheri Primar i Operimeve në Tunel** do të kontrollojë gjithë operimet në tunel dhe përreth tij, si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve operuese të tunelit. Ai duhet që:

- Të raportojë dhe marrë udhëzime nga ARRSH (Punëdhënësi);
- Të krijojë marrëdhënie komunikuese të besueshme me gjithë organizatat dhe autoritetet e interesuara sidomos për të siguruar një reagim të shpejtë në rast të ndonjë incidenti apo të një situatë emergjence si pasojë e një aksidenti;
- Të përgatisë planet e Sigurisë së Cilësisë për funksionimin e tunelit dhe metodologjitë e ndërhyrjeve si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve operuese të tunelit;
- Të sigurojë që ka një regjim të Sigurisë së Cilësisë për mbulimin e plotë dhe të vazhdueshëm të funksionimit të tunelit nëpërmjet operatorëve me eksperiencë që janë në kontroll gjatë gjithë kohës.
- Të sigurojë që ka një regjim të Sigurisë së Cilësisë për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve të tunelit, në mënyrë që tuneli të mbahet vazhdimisht në kushte të sigurta pune;
- Të përgatitë Planin e Menaxhimit të Aksidenteve, i cili përcakton rolet, përgjegjësitë dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga Menaxheri i Tunelit, Menaxherit të Operimeve dhe shërbimeve të emergjences.
- Rishikimin, familjarizimin dhe përditësimin, nese do të jetë i nevojshem, i “Manuali i Sigurisë së Funksionimit dhe Operimit të Tunelit” ne perputhje dhe duke perfshire Direktiven e BE 2004/54/EC dhe Ligjin Nr 158/2013 “ Për Sigurinë në Tunelet Rrugorë” Ky Manual i rishikuar dhe i përditësuar është subjekt i miratimit të Punëdhënësit, se bashku me këshillat suplementare dhe opinionet e Menaxherit Primar të Operimeve në Tunel;
- Të mbyllë tunelin në rast emergjence, nëse kjo konsiderohet e domosdoshme nga Menaxheri Primar i Operimeve të Tunelit, në cilësinë edhe të Oficerit të Sigurisë dhe Menaxherit të Tunelit dhe/ose nëse mund të kërkohet nga Punëdhënësi, dhe të rihapë tunelin për trafikun publik pas marrjes së autorizimit nga Punëdhënësi (ARRSH), të shpërndajë njoftimet për mbylljen dhe rihapjen tek autoritetet dhe organizatat e interesuara dhe të sigurojë hapjen e sigurtë të tunelit, sipas regjimeve të sigurimit të cilësisë së funksionimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve;
- Të koordinojë aktivitetet dhe të dhenat per operimin e tunelit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe

sistemeve, policinë e tunelit dhe shërbimin kundër zjarrit, nëpërmjet trajnimeve nëse është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha këto shërbime të funksionojnë sa më mirë, së bashku me organizatat dhe autoritetet e interesuara në funksionimin e tunelit, si dhe kundërpërgjigja ndaj situatave të emergjences;

- Të sigurohet që tuneli funksionon i sigurtë, me efektivitet dhe në mënyrë ekonomike (duke i kushtuar vëmendje të vecantë justifikimit të përdorimit ekonomik të gjeneratorëve gjatë kohës së mugesës së furnizimit me energji);
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe takimet e shpeshta me organizatat dhe autoritetet e interesuara për të siguruar koordinimin e gjithë veprimtarive të Menaxherit të Tunelit me gjithë veprimtaritë e përditshme që ndodhin dhe ndikojnë në tunel;
- Ne rastin e ndonjë modifikimi të rëndësishëm të strukturës, makinerive apo operimit në tunel do të kërkoet nje autorizim i ri nga Punëdhënësi (ARRSH) për operimin në tunel.

2 . Menaxheri Primar i Operimeve në Tunel si Oficer Sigurie duhet:

- Të sigurojë koordinim me shërbimet e emergjencës, të stimulojë përgatitjen e skemave të operimit për raste emergjente (zjarr në tunel, aksident i rëndë etj);
- Të marrë pjesë në planifikim, zbatim dhe vlerësimin e operimeve (ndërhyrjeve) të emergjencës;
- Të marrë pjesë në perkufizimin e skemave të sigurisë dhe të sigurojë që në përputhje me Artikullin 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE, janë kryer gjithë detyrat e mëposhtme:
 - a) Testimi dhe inspektimi në mënyrë të rregullt i tunelit dhe përgatitja e kërkesave të sigurisë;
 - b) Vendosija dhe përcaktimi i gjithë skemave organizative dhe operuese (duke përfshirë planet e kundërpërgjigjes në rastet e emergjencës), për trajnimin dhe pajisjen e shërbimeve të emergjencës;
 - c) Konturimi i plotë i procedurës për mbylljen e menjëhershme të tunelit në rast emergjence;
 - d) Zbatueshmëria e gjithë masave që duhen marrë për uljen e rrezikut.
- Sipas Artikullit 13 të Direktivës së BE-së, dhe VKM nr.648 dt.22.07.2015 "Per miratimin e kriterëve të caktimit të menaxherit , oficerit të sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjisë së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore", përgatit analizat e rreziqeve dhe shmangien e tyre në faza të ndryshme të hapjes së tunelit, marrja në konsideratë e gjithë faktorëve të projektimit dhe kushtet e trafikut që ndikojnë në sigurinë, duke përfshirë karakteristikat dhe llojin e trafikut, gjatësinë e tunelit, gjeometrinë e tunelit dhe parashikimin e numrit të automjeteve të renda në ditë (analizat do përsëriten në rastin e ndonjë ndryshimi të konsiderueshëm në trafik nga analizat e parashikuara).
 - e) Pjesëmarrja në vlerësimin e aftësive operuese të sistemit SCADA, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e sistemit operues në mënyrë sa më efektive dhe të dobishme;
 - f) Të verifikojë që stafi operues dhe personeli i shërbimeve të emergjencës janë trajnuar dhe merr pjesë në organizimin e veprimeve të rregullta që garantojnë kundërpërgjigje sa më korrekte gjatë rasteve të emergjencës;
 - g) Të marrë pjesë në organizimin dhe kryerjen e trajnimit të operatorëve që do të trajnohen dhe të skuadrave të mirëmbajtjes;
 - h) Të japë këshilla mbi vënien në punë të strukturës së tunelit, pajisjeve dhe operimin e tunelit;

- i) Të verifikojë që struktura e tunelit dhe pajisjet e tij mirëmbahen dhe riparohen;
- j) Të marrë pjesë në vlerësimin e çdo incidenti apo aksidenti të rëndë ashtu siç ilustruhet në Artikullin 5(3) dhe (4) të Direktivës së BE.

3. Drejtuesi i Mirëmbajtjes së Makinerive duhet:

- Të marrë përsipër përgjegjësitë për mirëmbajtje të vazhdueshme të pajisjeve dhe sistemeve që punojnë në tunel si dhe cilësi të garantuar të tyre.
- Duke patur parasysh faktin që shpesh herë do të mund të ketë edhe anomali në funksionimin e furnizuesve të energjisë, të ruajë një komunikim të vazhdueshëm me kompaninë e shpërndarjes së energjisë në mënyrë që të njoftohet sa herë do ketë situata me mungesë energjie, dhe të sigurohet që në rast mungese energjie të funksionojnë furnizimi me energji me anë të gjeneratorëve;
- Në rastet kur do të nevojitet zëvendësimi i ndonjë pajisje apo instalimi i ndonjë pajisje/sistemi të ri në funksion të tunelit, do nevojiten gjatë fazave të këtyre shërbimeve të ruajë një bashkëpunim sa më të ngushtë me ekipet e punës apo nënkontraktorë të mundshëm për t'u harmonizuar sa më mirë për të shmangur konfliktin ndërmjet punimeve të instalimit me ato të ndërhyrjes në tunel apo të mirëmbajtjes së makinerive.
- Të kontrollojë dhe të sigurojë që pjesët e këmbimit të makinerive që mbahen në magazinim, të jenë të ruajtura mirë dhe në gjendje që të mbajnë tunelin në kushte shumë të sigurta pune gjatë gjithë kohës;
- Të regjistrojë dhe të arshivojë të dhënat dhe rezultatet e dala nga inspektimet e pajisjeve dhe sistemeve, si edhe gjatë mirëmbajtjes së tunelit.

D. LISTA E RAPORTEVE/DOKUMENTAVE DHE PROGRAMI I SHPËRNDARJES

- 1). Nuk duhet nënvlersuar rëndësia e një raportimi periodik, të detajuar dhe në kohën e duhur. Më poshtë janë përcaktuar raportet dhe dokumentat që duhen përgatitur, frekuenca e tyre, paraqitja në kohë, si dhe tema e përmbajtjes së tyre. Ka shumë rëndësi që Menaxheri i Tunelit të angazhohet në pozicionin e ekspertizës së kushteve të Shërbimeve të Operimeve të Tunelit si dhe Raporteve/Dokumentave të tij për të pasqyruar dhe transferuar këtë ekspertizë
- 2). Menaxheri i Tunelit do të dorëzojë te Punëdhënësi (ARRSH) raportet dhe dokumentacionin, përkatësisht si më poshtë:

- (a) **Raporti fillestar**- me një afat fundi i muajit të parë, pas lidhjes së kontratës.

Në këtë raport do të pasqyrohen të gjitha të dhënat e stafit të angazhuar për realizimin e kontratës, strategjitë për përbushjen e detyrave të kontratës, problemet e hasura me gjendjen aktuale të secilit prej sistemeve të tunelit, strategjitë për përballimin e situatave emergjentë, e tjerë. (3 kopje në gjuhen shqipe)

- (b) **Raportet Mujore** - fillojnë nga fundi i muajit të parë të plotë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet Kontraktorit dhe Punëdhënësit (ARRSH).
(3 Kopje ne Shqip)

Dorëzimi: 1 javë pas ditës së fundit të çdo muaji.

Raportet Mujore do të japin të dhëna për personelin sipas turneve (përfshirë policinë, brigadat e zjarrëfiksave dhe ekipet e mirëmbajtjes), ngjarjet, dëmtime/difekte të pajisjeve, incidentet dhe veprimet e ndërmarra për kontrollin e tunelit. Përdorimi i energjisë është çështje e rëndësishme, prandaj ndërprerjet e furnizimit me energji dhe përdorimi i gjeneratorëve duhet regjistruar.

Raporti i Menaxherit të Tunelit, do të përfshijë Raportin Mujor të Oficerit të Sigurisë, i cili duhet të nënvizojë çdo zonë problematike dhe njëkohësisht raportet specifike mbi ndonjë aksident dhe/ose lëndime të personave. Menaxheri i Tunelit do të japë detaje të ndonjë rasti mosfunksionimi të kënaqshëm të ndonjë pajisjeje apo sistemi dhe propozime për ndonjë modifikim të dobishëm.

Raporti i Menaxherit të Tunelit do të regjistrojë të dhëna për mirëmbajtjen e planifikuar ose të rastit që është kryer gjatë muajit dhe riparimin dhe/ose zëvendësimin e ndonjë pajisjeje. Raporti duhet të japë një inventar të pjesëve në magazinë.

Menaxheri i Tunelit do të raportojë mbi marrëdhënjet e tij me Njësinë e Policisë e cila mbulon zonën e tunelit si dhe të gjithë autoritetet e tjera të përfshira në këtë shërbim, do të kryejë inspektime manuale fizike të përditshme në tunel. Frekuenca e këtyre inspektimeve do të përcaktohet nga vetë stafi drejtues i Menaxherit të Tunelit në varësi të gjendjes, që mund të jetë edhe disa herë në ditë në rast avarie apo parashikimi të ndonjë situatë të rrezikshme që do të vlerësohet po nga stafi drejtues permanent në kontratë.

Menaxheri i Tunelit duhet t'i bashkëngjijë çdo Raporti 3-mujor, një vlerësim konfidencial për ecurinë e stafit të operatorëve lokalë të tunelit që trajnohen (stazhierë) dhe teknikëve të mirëmbajtjes.

Këto vlerësime do të jenë në formën e fletëve të vecanta që tregojnë:

- Numrin e orëve që i është dashur Menaxherit për kryerjen e çdo detyre;
- Një sistem vlerësimi për të treguar nivelin e njohurive dhe kuptimin e detyrës, si në rastin kur ai është në gjendje ta kryejë atë
- Në të njëjtën kohë, Menaxheri i Tunelit duhet të japë rekomandimet e tij në lidhje me operimin e tunelit në të ardhmen.

Menaxheri i Tunelit duhet të bashkëngjijë një model të Raportit Mujor në Raportin e tij Fillestar dhe ta modifikojë më pas mënyrën e raportimit në varësi të komenteve që mund të bëhen nga Punëdhënësi.

(c) Draft Raporti Perfundimtar

(3 Kopje ne Shqip)

Dorëzimi: 1 muaj para përfundimit të kontratës.

Draft Raporti Perfundimtar do të paraqesë një përshkrim nëse Kontrata ka qënë e suksesëshme.

Raporti do të përfshijë ndërmjet të tjerave, por jo limituar, edhe informacionet e mëposhtme:

- Pasqyrë të përgjithshme të Kontratës për Funksonimin e Tunelit;
- Performancën e Kontratës në lidhje me Termat e Referencës;
- Shpjegime për ndryshime kundrejt Termave të Referencës;

- Shpenzime në lidhje me buxhetet fillestare;
- Shpjegime për ndryshimet kundrejt këtyre buxheteve;
- Numrin e burimeve njerëzore të punësuar gjatë kohëzgjatjes së Kontratës;
- Të përshkruajë eksperiencat e ngjashme të Kontraktorit që ndjek funksionimin e Tunelit dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tunelit. Ky kapitull i raportit duhet të jetë detajuar në drejtim të fuqisë punëtore, kërkesave materiale dhe administrative, si edhe ndonjë çështje tjetër që mund të ndihmojë Punëdhënësin në të ardhmen në lidhje me programet e mirëmbajtjes dhe funksionimit të tunelit;
- Dokumentacion të plotë me të gjitha të dhënat për Sistemet e Mirëmbajtjes dhe Garancisë së Cilësisë së funksionimit të Tunelit për të mundësuar dorëzimin e perpiktë të punëve për funksionimin e tunelit dhe përgjegjësi të mirëmbajtjes.
- Një listë kontrolli të aprovuar për funksionimin e tunelit dhe aktivitetet e mirëmbajtjes kundrejt të cilave do të punohet nga një Kontraktor tjetër që do të ndjekë funksionimin e Tunelit në të ardhmen.

(d) Raporti Përfundimtar

(3 Kopje në Shqip)

Dorezimi: 2 javë pas përfundimit të afatit kontraktual ose pas komenteve të bera nga ARRSH mbi Draftin e Raportit Përfundimtar, cilido qoftë me i vonshmi.

Raporti Përfundimtar do të bazohet në Draft Raportin Përfundimtar, por duke përfshirë ndonjë koment/sugjerim të bërë nga palët recensuese (MTI, ARRSH).

3) Raportet zyrtare do të paraqiten të printuara dhe në mënyrë elektronike në CD/DVD.

E. TË DHËNA, SHËRBIME LOKALE, PERSONEL, DHE FACILITETE

- Të dhënat që do të jepen nga Punëdhënësi, do të organizohen nëpërmjet dorëzimit nga Kontraktori aktual i Tunelit i mëparshëm drejt të riut, dhe do të përfshijnë:
- Set të plotë të manualeve të operimit dhe rekordet të cilat do merren nga Kontraktori i mëparshëm i operimit të Tunelit.
- Manuale përdorimi të pajisjeve elektro-mekanike të instaluara në tunel, pajisjeve të operimit dhe komunikimit të tunelit, rekordet të cilat do merren nga Kontraktori i mëparshëm i operimit të Tunelit.
- Menaxheri i Tunelit duhet të parashikojë në ofertën e tij, koston e mirëmbajtjes së gjithë faciliteteve të dhëna, pajisjeve ndihmëse, artikujve të konsumueshëm, veshje sigurimi/pajisje për stafin.
- Punëdhënësi do të bëjë një kontratë me OSHEE, për furnizimin e tunelit me energji elektrike. Punëdhënësi do të rimbursojë Menaxherin e Tunelit për karburantin e harxhuar për prodhimin e energjisë elektrike në tunel me anë të gjeneratoreve, pasi Menaxheri i Tunelit t'a justifikojë me rekorde këtë konsum me të dhënat nga sistemi OSHEE, për rastet e ndërprerjes dhe luhatjeve të energjisë elektrike).

- Menaxheri i Tunelit duhet të parashikojë në ofertën e tij, kostot për prurjen e automjeteve shtesë, të cilat ai i konsideron të nevojshme si dhe të parashikojë në ofertën e tij kostot për siguracionin, furnizimin me karburant, riparimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha makinave që do përdoren prej stafit të tij të angazhuar në këtë kontratë si dhe brigadat e tij të mirëmbajtjes.

Ai duhet të parashikojë në ofertën e tij në një shumë Lump Sum kostot për mirëmbajtjen e ambienteve të tunelit dhe objekteve rreth tij, transportin e stafit, pastrime, shpenzime kancelerie, shpenzime telefoni dhe internet, shpenzime për rifreskimin për sinjalistikën horizontale brenda tunelit, shpenzime për pastrime drenazhesh e pusetash.

- Punëdhënësi ka vendosur marreveshje institucionale me Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit për instalimin e njësisë së tyre (brigada e zjarrfiksave), të jetë përherë e instaluar në funksion të Tunelit. Kjo njësi është gjithë kohën në gjendje gadishmërie dhe e pajisur me gjithë elementët dhe kostot operuese të luftës kundër zjarrit në tunel, makinat zjarrfikse, shkurmen kundra zjarrit, fikëset e zjarrit dhe pjesë të tjera konsumi.
- Menaxheri i Tunelit do të perllorise në ofertën e vet shumën e duhur mujore për gjithë shpenzimet e cdo lloj komunikimi.
- *1 (nje) automjet karrotrec dhe autovinc me kovë për ngritje në lartësi*
- *1 (nje) automjet, Makinë Tip 4x4 fuoristrade*, të jetë në dispozicion të stafit ku llogaritet (karburant dhe mirëmbajtje automjeteve) në kohë të plotë të kontratës.

F. MARRËVESHJET INSTITUCIONALE

1. Menaxheri i Tunelit do të raportojë te Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar si Punëdhënësi.

G. PREZANTIMET TEKNIKE QË DO PËRGATITEN NGA MENAXHERI I TUNELIT

1. Propozimi i Menaxherit të Tunelit do përfshijë një prezantim tabelar në lidhje me Stafin e tij Drejtues (Kryesor) të propozuar, duke detajuar:

- Emrin e ekspertit
- Pozicionin e propozuar
- Vitet e eksperiencës
- Mosha
- Fushat e specializimit
- Gjuhët e huaja dhe certifikatat e tyre (e folur dhe e shkruar)

2. Propozimi i Menaxherit të Tunelit do përfshijë me qëllim përmirësimin (e arsyeshëm) të Kontratës, si më poshtë:

- Çdo koment mbi Termat e Referencës për rëndësinë që ka performanca e

suksesshme e aktivitetit, në veçanti objektivat e tij dhe rezultatet e pritshme, duke demonstruar kështu shkallën e mirëkuptimit të kontratës. Çdo koment për kontraditat që mund të shfaqen në Termat e Referencës apo mosrealizimi i qëllimit të tyre nuk do futet në Kontratën përfundimtare;

- Një opinion mbi çështjet themelore që lidhen me realizimin e suksesshëm të objektivave të kontratës dhe rezultatet e pritshme;
- Një spjegim mbi rreziqet dhe sugjerimet që ndikojnë në realizimin e Kontratës.

3. Propozimi i Menaxherit të Tunelit do përfshijë, në lidhje me strategjinë e tij të realizimit të Kontratës, si me poshtë:

- Një përmbledhje të metodikës së propozuar për performancën e Kontratës;
- Një listë me aktivitetet e propozuara që konsideron të jene të nevojshme për përmbushjen e objektivave të Kontratës;
- Detyrat dhe realizimet;
- Në rastin e ofertimit nga një konsorcium apo bashkim operatorësh ekonomik, duhet një përshkrim me detyrat që do kryejë secili anëtar si dhe shpërndarjen dhe marrëveshjet për këtë detyrë, si do kryhet mes tyre;
- Një përshkrim të shërbimeve mbështetëse, që njësia e ekspertëve do ketë nga Menaxheri i Tunelit gjatë performancës së Kontratës;

4. Propozimi i Menaxherit të Tunelit në lidhje me Programimin Kohor të Veprimtarisë së tij do përfshijë, si më poshtë :

- Kohën, sekuencën dhe kohëzgjatjen e veprimtarive të propozuara, duke marrë parasysh që periudha e mobilizimit do të jetë e menjëhershme pas lidhjes së kontratës;
- Identifikimi dhe përcaktimi i objektivave madhore në Kontratë, duke përfshirë një tregues se si realizohen këto detyra që mund të reflektohen në çdo raport, veçanërisht ato që nënvizohen në Termat e Referencës;
- Plotësimin e Preventivit të Tenderit të paraqitur në formën e një table EXEL, duke përfshirë dhe përcaktuar numrin e muajve të punës të kërkuar për çdo kategori të anetarëve të Stafit Kryesor (drejtues) dhe jo Kryesor (mbështetës), (stafi jo-mbështetës është i përfshirë në njësi dhe çmimet mujore).

H. TERMAT E REFERENCES PER FUNKSIONIMIN DHE MIRËMBAJTIEN E TUNELIT TË KRRABES

1. KATEGORITË E STAFIT

2. NUMRI TOTAL I STAFIT TË NEVOJSHËM

KATEGORITË E STAFIT (*kërkesat*)

1	MENAXHER DREJTUES PER OPERIMET NË TUNEL / OFICER SIGURIE.	Duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri ndertimi ose inxhinieri mekanike (transport) si dhe eksperiencë të paktën 5 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugore dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e të aksidenteve rrugore.
2	MENAXHER I MIREMBAJTJES SE PAJISJEVE / MAKINERIVE.	Me arsimin inxhinieri elektrike ose mekanike, (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.
3	OPERATORË TUNELI QË DO TË TRAJNOHEN OSE MUND TË JENË	Diplomë në Inxhinieri Elektronike/Elektrike/Mekanike
4	TEKNIK MIRËMBAJTJE PAJISJESH TË TUNELIT	Teknikë Mirëmbajtje Pajisjesh, të kualifikuar mjaftueshëm dhe me experiencë, që do trajnohen dhe drejtohen nga Përgjegjësi i Mirëmbajtjes së Pajisjeve, gjatë kohës së zbatimit të kontratës, sipas Planit të Sigurimit të Cilësisë së mirëmbajtjes së pajisjeve që do operojnë në tunel.
5	MENAXHER PERSONELI / FINANCIER	Diplomë për ekonomik. Përveç kësaj, një Diplomë Masteri për Burimet Njerezore do të ishte ideale për këtë pozicion pune.
6	ELEKTRICISTË	Elektracistë të specializuar me dëshmi kategorie nga IQT, që do të marrë pjesë në operationet për ndërrimin e pjesëve MV të paneleve elektrike që duhet të behen vetëm në presencë të inxhinierit E/M ose nga personel me eksperiencë dhe të trajnuar.

7	MEKANIKË	Mekanikë të specializuar me dëshmi kategorie nga IQT, me experiencë dhe njohuri të mira në shpime, saldime dhe instalime mekanike.
8	HIDRAULIKË	Hidraulikë të specializuar me dëshmi kategorie nga IQT, me experiencë dhe aftësi teknike për pajisjet/sistemet hidraulike, instalimet hidraulike dhe me experiencë ne rrjetet
9	SHOFER (makineri të rënda)	Patentë automjeti për katëgoritë e rimorkiatorëve dhe makinave të rënda.
10	SHOFER (Makina fuoristrade 4X4)	Patentë makinë e thjeshtë.

2. NUMRI TOTAL I STAFIT TË NEVOJSHËM

NUMRI NE TOTAL I STAFIT TË NEVOJSHËM – 12 PERSONA		
1	MANAXHER PRIMAR I OPERIMEVE NË TUNEL / OFICER SIGURIE	1 PERSON
2	MENAXHER I MIRËMBAJTJES SË PAJISJEVE/MAKINERIVE	1 PERSON
3	OPERATORË TUNELI LOKALE	3 PERSONA
4	TEKNIKË MIREMBAJTJE TUNELI	1 PERSONA
5	MENAXHER PERSONELI /FINANCIER	1 PERSON
6	ELEKTRICISTË	1 PERSON
7	MEKANIKË	1 PERSON
8	HIDRAULIKË	1 PERSON
9	SHOFERË (makineri të renda)	1 PERSON
10	SHOFERË (makineri te thjeshta)	1 PERSONA



